



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 23.12.2023

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, duke u bazuar në nenin 2 të Marrëveshjes së Grantit TF0C3867-XK të nënshkruar me datën 28 qershor 2024 nga Republika e Kosovës dhe Banka Botërore dhe në vendimin Nr. 01B-246 datë 23.12.2024 bën,

THIRRJE PËR REGJISTRIMIN E INSTITUCIONEVE TË EDUKIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME NË PILOTIMIN E PROGRAMIT TË KUPONAVE NË KOMUNËN E PRISHTINËS, LIPJANIT, GJILANIT DHE PRIZRENIT

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka filluar zbatimin e Pilotimit të Programit të Kuponave. Programi ka për qëllim të përmirësojë qasjen e fëmijëve 3 deri në 5 vjeç në Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (IEFH) nga familjet të cilat janë të regjistruara në Skemën e Asistencës Sociale. Nëpërmjet Programit të Kuponave, MASHTI do t'i rimbursojë institucionet private, publiko-private dhe ato me bazë në komunitet të cilat ofrojnë shërbime të edukimit në fëmijërinë e hershme për fëmijët e përzgjedhur.

Programi i Kuponave do të zgjas nga muaji dhjetor 2024 deri në qershor 2027. Ndërsa faza e pilotimit do të zgjas (pas përmbylljes së aplikimeve dhe përzgjedhjes) për 6 muaj të vijimit të edukimit nga fëmijët në IEFK.

Komunat e përzgjedhura për pilotim janë:

1. Komuna e Prishtinës;
2. Komuna e Lipjanit;
3. Komuna e Gjilanit dhe;

4. Komuna e Prizrenit.

IEFH-të të cilat operojnë në këto komuna ftohen të regjistrohen në Programin e Kuponave në mënyrë që të ofrojnë shërbime të edukimit në fëmijërinë e hershme.

Specifikisht, IEFH-të të cilat mund të aplikojnë në kuadër të programit përfshijnë:

- Institucionet parashkollore private;
- Institucionet parashkollore në partneritet publiko-privat dhe;
- Format e tjera alternative të organizimit përfshirë institucionet me bazë në komunitet.

Kriteret e regjistrimit të IEFH-ve në program janë:

- Të jenë të licensuara nga MASHTI për ofrimin e shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme;
- Të kenë së paku 1 vend të lirë për regjistrimin e fëmijëve përfitues.

Shpenzimet të cilat do të mbulohen nga programi:

- Pagesa e shërbimit për edukimin në fëmijërinë e hershme për gjashtë muaj të pilotimit;

Komuna	Shuma e cila rimbursohet nga programi për fëmijë për muaj
Prishtinë	150 Euro
Prizren	100 Euro
Gjilan	90 Euro
Lipjan	100 Euro

- Pagesa e transportit të fëmijës në kopsht (vetëm për institucionet të cilat ofrojnë shërbime të transportit)

Shuma e pagesës së transportit do të përcaktohet nga Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave në shumën prej 50 euro deri në 80 euro për fëmijë varësisht nga komuna përkatëse dhe distanca rrugore.

Procedura e aplikimit:

Aplikimi realizohet vetëm nëpërmjet e-Kosova në linkun: <https://ekosova.rks-gov.net/Security?ReturnUrl=%2F597>

Të dhënat dhe dokumentet e kërkuara në procedurë të aplikimit janë:

- Adresa e institucionit;
- Komuna në të cilën operon;
- Deklarimi i vendeve të lira të disponueshme për pranimin e fëmijëve;
- Deklarimi i vendeve të lira të disponueshme për pranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- Informatë nëse institucioni ofron transport;
- Numri i llogarisë bankare të institucionit.

Afati për regjistrim

Regjistrimi është i hapur për 15 ditë nga data 23.12.2024 dhe përfundon me datën 6.01.2025.

Departamenti përgjegjës për licensimin e IEFH-ve pranë MASHTI-t do të bëjë vlerësimin e aplikimeve sa i përket përmbushjes së kriterëve.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrin e telefonit: 038 200 65048 dhe/ose duke dërguar e-mail në adresën: programiikuponave@rks-gov.net.